



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ р./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 89-të, të mbajtur më 20.07.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-8179/1 të datës 15.09.2022, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-8179/1 të datës 15.09.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më 15 shtator 2022, një kërkues i panjohur ka bërë denoncim me pretendime për emërim të drejtorit në mënyrë të paligjshme të _____

_____ pas së cilës është formuar lënda me numër 12-8179/1 të datës 15.09.2022 . Në denoncim thuhet se drejtori i emëruar, në kundërshtim me materialin ligjor, nuk ka përvojë të mjaftueshme pune në profesion, përkatësisht informacioni, dhe diploma e fituar dhe lloji i arsimit nuk ishte i përshtatshëm për atë pozitë.

Pas analizimit të pretendimeve në fjalë dhe kontrollit të të dhënave dhe informacioneve të disponueshme publikisht në lidhje me kualifikimet e nevojshme dhe kualifikimet dhe angazhimet profesionale të personit të deklaruar në denoncim, KSHPK-ja arrin në përfundimin se nuk ka bazë për veprim kompetent për këtë çështje, sepse pretendimet në kërkesa tregojnë për një interpretim të gabuar të dispozitave ligjore nga parashtruesi i denoncimit.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: P.B

Miratoi: K.N., anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

